

RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI

2023

—
VALBONA SULÇE KOLGECI
FJOLLA SPANCA

Autorë: Valbona Sulçe Kolgeci dhe Fjolla Spanca

Redaktor: Dorentina Hysa

Ekspert i metodologjisë kërkimore: Snježana Milivojevic

Ekspert i metodologjisë kërkimore dhe redaktor: Stefan Janjic

Botues: Instituti Shqiptar i Medias

.....



Rrjeti i Raportimit të Diversitetit 2.0 - RDN 2.0 është krijuar me qëllim për të ndikuar efektivisht raportimin në media të etnisë, fesë dhe gjinisë në Ballkanin Perëndimor.

Partnerët e projektit përfshijnë Institutin për Diversitet në Media (UK), Institutin Shqiptar të Medias, Qendra për Gazetari Investigative (BiH), Qendra për Gazetari Investigative Mali i Zi, Rrjeti Juglindor për Profesionalizimin e Medias (SEENPM), Instituti për Studime të Komunikimit (ICS), Kosovo 2.0, Instituti për Diversitet në Media (WB).

.....



Funded by
the European Union



B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND



Ky publikim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, Trustit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe Raportimit të Rrjetit të Diversitetit 2.0 dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Trustit Ballkanik për Demokraci, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë apo partnerëve të tyre.



RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN E URREJTJES NË SHQIPËRI 2023

VALBONA SULÇE KOLGECI
FJOLLA SPANCA

Përmbajtje

5	Hyrje
6	Metodologjia kërkimore
7	Narrativat dhe mesazhet e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit (HDD)
7	Tabllo e përgjithshme e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri
8	Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit ndaj përkatësisë etnike
11	Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit ndaj gjinisë
14	Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit ndaj LGBTQ+
17	Analiza krahasimore
18	Angazhimi i vendit kundër gjuhës së urrejtjes
19	Konkluzione
20	Referenca

Hyrje

Ky raport vjetor paraqet situatën në lidhje me gjuhën dhe diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit në mjedisin mediatik shqiptar. Raporti bazohet në monitorimin e mediave gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2023. Subjekt i monitorimit kanë qenë incidente që përmbanin mesazhe urrejtje dhe diskriminimi (*hateful and discriminative discourse - HDD*) të prodhuara, shpërndara apo edhe të toleruara nga media, duke përfshirë si mediat tradicionale, mediat e reja dhe mediat sociale.

Rastet problematike u identifikuan duke përdorur kërkimin me fjalë kyçe dhe duke bërë monitorim ditor të organeve të ndryshme mediatike. Secili nga rastet e identifikuar u analizua, dhe më pas u klasifikua në bazë të sistemit të raportimit të ideuar nga Prof. Snježana Milivojević. Monitorimi u përqendrua mbi incidente që përmbanin gjuhë urrejtje mbi baza gjinore, përkatësie etnike, fetare, ndaj pakicave seksuale, emigrantëve dhe refugjatëve. Gjatë studimit u identifikuan edhe kategori të reja, si sulme ndaj gazetarëve, kundërshtarëve politikë, etj, që u raportuan dhe u përfshinë në këtë raport.

Tre grupet që vihen më shpesh në shënjestër nga gjuha e urrejtjes dhe diskursi diskriminues janë gjinia (41%), përkatësia etnike (38%) dhe pakicat seksuale (11%). Çështja e gjuhës së urrejtjes mbi baza gjinore mbetet një nga shqetësimet kryesore. Gjatë vitit 2023 kemi vënë re se media, gazetarë, figura publike, artistë, profesionistë e intelektualë nuk kanë hezitur që të bëjnë deklaratatë të ashpra kundër grave dhe vajzave të të gjitha moshave dhe prejardhjeve, duke përfshirë: gazetaret, nënat e reja, vajzat adoleshente, këngëtarët, gratë mbi 30 vjeç, të pastreha që detyrohen të punojnë si prostituta, vajza të reja me aftësi të kufizuara mendore, etj. Edhe rastet kur burrat dhe djemtë portretizohen në mënyrë përçmuese zakonisht kanë të bëjë me incidente që lidhen me situatën e grave brenda familjes ose me marrëdhëniet me partnerët e tyre. Për sa i përket përkatësisë etnike, ka një rritje të diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit ndaj emigrantëve dhe refugjatëve, si pasojë e disa iniciativave të fundit të qeverisë në lidhje me mikpritjen e përkohshme të emigrantëve nga Italia.

Për fat të keq, **gjuha e urrejtjes buron kryesisht nga vetë media – gazetarë dhe analistë.** Media vazhdon të përdorë stereotipe të dëmshme dhe diskriminuese për “Të tjerët” kur raportohet mbi grupe të ndryshme të shoqërisë. Ka patur edhe raste sporadike kur politikanë, artistë, intelektualë, pedagogë, persona të famshëm dhe individë me ndikim në publik, kanë përdorur fjalor diskriminues dhe kanë mbajtur qëndrime agresive mbi tema të caktuara. Problemi është se këta persona përdorin platforma mediatike për të përhapur këto narrativa të dëmshme, madje edhe në media kombëtare, pa u kundërshtuar nga gazetarët apo drejtuesit e emisioneve.

Në raportimin e lajmeve të kronikës së zezë nga bota vihet re një tendencë e veçantë për t'u përqendruar mbi orientimet seksuale të palëve të përfshira në incidente, çka tregon se ka përpjekje për të tërhequr vëmendjen ndaj ngjarjeve dhe çështjeve që lidhen me pakicat seksuale. Monitorimi i medias ka luajtur rol të rëndësishëm në shmangien e përshkallëzimit të gjuhës së urrejtjes në raportim, por sidoqoftë ka tendenca dhe përpjekje të vazhdueshme për të “normalizuar” këtë lloj diskursi.

Nga ana tjetër, viti 2023 shënoi një zhvillim pozitiv pasi ka patur një rritje të rolit të organeve rregullatore në parandalimin e seksizmit në mediat audiovizive. Kjo erdhi kryesisht si rezultat i ndryshimit të ligjit për mediat audiovizive më 13 Prill 2023, me futjen për herë të parë të përkufizimit të seksizmit dhe parashikimit të sanksioneve për operatorët që shkelin ligjin. Edhe Kodi i Ri i Transmetimit të AMA-s, që hyri në fuqi në Maj 2022, ka një kapitull mbi seksizmin dhe barazinë gjinore. **Komisioneri kundër Diskriminimit ka akumuluar eksperiencë në lidhje me praktikatat dhe metodat e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në media dhe ka ofruar analiza të plota profesionale për të shpjeguar vendimet e marra, duke krijuar një model që duhet ndjekur edhe nga institucione të tjera.** Po kështu, ka një nivel më të lartë ndërgjegjësimi dhe reagimi nga OSHC-të në lidhje me diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit në media, duke filluar nga shoqatat rome dhe egjiptiane, organizatat për të drejtat e grave, etj.



Metodologjia kërkimore

Të dhënat për këtë raport janë mbledhur gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2023. Monitorimi i medias është kryer çdo javë për të identifikuar dhe raportuar raste të gjuhës së urrejtjes mbi gjininë, përkatësinë etnike, fenë, pakicat seksuale, emigrantët dhe refugjatët.

Studiuesit e fushës kanë krijuar një sistem për të identifikuar dhe denoncuar këto incidente në media dhe ky studim ka përdorur këtë instrument për të mbledhur informacione mbi datën e publikimit të incidentit, vendin ku ka ndodhur, llojin e gjuhës së urrejtjes, përmbajtjen apo narrativën e diskutit, autorët e incidentit, mediat ku u identifikua dhe shtrirja në publik. Për rastet më serioze u përgatitën dhe u publikuan reagime në media, duke përfshirë artikuj, postime, letra drejtuar redaktorëve dhe denoncime të rasteve në platformat e mediave sociale.

Të gjitha të dhënat e mbledhura iu nënshtruan analizave sasiore dhe cilësore. Analiza sasiore paraqet një pasqyrë të numrit të rasteve të përdorimit të gjuhës të urrejtjes dhe diskriminimit për secilën kategori, ndërsa analiza cilësore u përqendrua mbi analizimin e narrativave, analizën emocionale, dhe analizën e vizibilitetit për të krijuar një ide më të qartë mbi narrativat në media. Analiza emocionale (*sentiment analysis*) bazohet mbi metodën e zhvilluar nga universiteti George Washington¹ që i rendit rastet në gjashtë shkallë intensiteti:

- 1. Kundërshtim** - Retorikë që përfshin mosrënien dakord me një ide në nivel mendor. Përballja apo kundërshtimi i pretendimeve, ideve dhe besimeve të një të grupi, ose përpjekja për t'i ndryshuar ato.
- 2. Reagime negative** - Retorikë që përfshin akte negative jo të dhunshme ndaj grupit.
- 3. Portretizim negativ** - Retorikë që përfshin karakterizime dhe fyerje jo të dhunshme.
- 4. Demonizim dhe çhumanizim** - Retorikë që përfshin veshjen me karakteristika nënjerëzore apo mbinjerëzore të individëve apo grupeve të caktuara.
- 5. Nxitje e dhunës** - Retorikë që nxit shkaktimin e dëmtimeve fizike ose dëshirën për të ushtruar dhunë fizike.
- 6. Vdekje** - Retorikë që kërkon vrasje ose eliminimin e një grupi.


Qëllimi i këtij raporti kërkimor është të kontribuojë në njohjen më të mirë dhe zbërthimin e modeleve të gjuhës diskriminuese dhe urrejtjes në media dhe komunikimin në Shqipëri, dhe të përmirësojë aftësinë e shoqërisë për t'iu kundërvënë diskutit të urrejtjes dhe diskriminimit dhe për të krijuar kundër-narrativa për promovimin e të drejtave të njeriut, diversitetit dhe tolerancës.

¹ Universiteti George Washington (2019). Monitoring Hate Speech in the US Media. Working paper. Media and Peacebuilding Project. (Monitorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat amerikane. Punë kërkimore. Projekti i Medias dhe Sigurimit të Paqes) faqe 5. Mund të lexohet në internet tek kjo adresë: [Monitoring-Hate-Speech-in-the-US-Media-3_22-20h5kk.pdf](https://www.washington.edu/peacebuilding/workingpapers/monitoring-hate-speech-in-the-us-media-3_22-20h5kk.pdf) (cpb-us-el.wpmucdn.com)

Narrativat dhe mesazhet e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit

1. Tabllo e përgjithshme e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në Shqipëri

Grafiku i monitorimit të medias në Shqipëri mbi diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit gjatë vitit 2023 i ngjan grafikut nga studime të mëparshme ku gratë janë grupi që vihet më shpesh në shënjestër nga gjuha e urrejtjes dhe diskursi diskriminues, duke arritur në nivele alarmante (41%), e ndjekur nga përkatësia etnike (38%), dhe pakicat seksuale (11%).



Sidoqoftë, ka patur edhe objektiva të tjera në shënjestrën e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit. Edhe gazetarët (2%) preken nga gjuha e urrejtjes, ndonëse edhe këtu kemi një element të fortë gjinor. Janë regjistruar gjithashtu një numër rastesh që sulmojnë kategori të tjera, si gra dhe vajza dhe persona me aftësi të kufizuara, ose gratë dhe përkatësinë e tyre fetare.

Nga ana tjetër, një element pozitiv është fakti se feja vazhdon të jetë kategoria më pak e prekur nga diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit, duke konfirmuar reputacionin e Shqipërisë si vend i tolerancës fetare dhe bashkëjetesës paqësore. Për të konfirmuar këtë tendencë, ky raport monitorimi sjell një shembull pozitiv mbi raportimin në mediat shqiptare të djegies së Kuranit në Suedi, një incident që shkaktoi shumë polemika nëpër botë. Mediat shqiptare raportuan mbi ngjarjen në mënyrë neutrale, duke i dhënë hapësirë edhe deklaratave të Papë Françeskut që dënoi djegien e librit të shenjtë.² Por ajo që ka më shumë rëndësi është fakti se edhe pjesa dërrmuese e komenteve në postimet e lajmeve në mediat sociale ishin pozitive, ku besimtarët e krishterë shprehën simpatinë dhe mbështetjen për besimtarët e fesë islame, në përputhje me bashkëjetesën shumëfetare në Shqipëri dhe qasjen paqësore ndaj fesë.

“Për ne katolikët nuk është çështje besimi, është çështje respekti, respekti ndaj miqve dhe dashmirëve tanë myslimanë.”

² <https://www.facebook.com/100041829021769/posts/994502431954048>
https://www.instagram.com/p/CuOxrs_Njzq/?img_index=1

2. Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit ndaj përkatësisë etnike

Në krahasim me vitin e kaluar pati një rënie të lehtë në përdorimin e gjuhës së urrejtjes mbi etninë, por u vu re një tendencë shqetësuese në lidhje me gjuhën e urrejtjes ndaj emigrantëve. Raporti i monitorimit tregon se grupet kryesore në shënjestër të këtyre narrativave vazhdojnë të jenë po ato: serbët, grekët dhe romët. Sidoqoftë, në disa raste ai drejtohet edhe kundër refugjatëve të huaj dhe kosovarëve.

Ngjarjet që shërbyen si nxitësit kryesorë për diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit mbi përkatësinë etnike ishin zgjedhjet lokale të mbajtura në Maj dhe kandidatura e Alfred Belerit si kandidat për kryetar bashkie në Himarë, si dhe marrëveshja midis Shqipërisë dhe Italisë për të hapur kampe refugjatësh në territorin shqiptar deri sa të kryhet procesi i riatdhesimit. Ngjarje të tjera ishin kriza në veri të Kosovës pas zgjedhjeve të pjesshme në Leposaviq, që shkaktoi reagime të shumta ndërkombëtare ndaj qeverisë së Albin Kurtit, duke përfshirë edhe tensionet mes tij dhe kryeministrit Edi Rama, i cili vendosi në mënyrë të njëanshme të anulojë një mbledhje të përbashkët të dy qeverive. Vihet re qartë se kur protagonistja e një ngjarje është një grua, komentet janë shumë më të ashpra se sa ndaj meshkujve të përfshirë në të njëjtën ngjarje.

Ajo që vihet re në gjuhën e urrejtjes ndaj serbëve është se kushdo që i mbështet apo bashkëpunon me ta është antishqiptar, ose punon kundër interesave kombëtare të Shqipërisë. Ky lloj reagimi nuk ndikohet nga statusi i personave që kryejnë këto veprime, nëse janë persona publikë apo jo. Në rastin e personazheve publike presioni është aq i madh sa detyrohen të lëshojnë deklarata për të justifikuar veprimet e tyre, ndërsa personazhet jopublike karakterizohen si persona për të ardhur keq, “pa tru” ose “pa shtyllë kurrizore.”

Këngëtarja me origjinë shqiptare Rita Ora u filmua duke valëvitur një flamur serb të marrë nga një fanse gjatë një koncerti në Hungari, dhe kjo ngjalli shumë reagime negative në internet³. Pati shumë postime që shprehnin zemëratë mbi veprimin e këngëtares, ndonëse ajo e ka deklaruar hapur në shumë raste origjinën e saj shqiptare. Megjithatë ajo tha më pas se nuk i kishte kushtuar fare rëndësi se cilit shtet i përkiste ai flamur ndërsa po këndonte, dhe la të kuptohej se e kishte ngatërruar me flamurin hungarez – duke pasur parasysh edhe ngjyrat e ngjashme – mediat vazhduan të publikonin artikuj dhe komente që e bënë me faj. Në një artikull të publikuar nga portali JOQ⁴ u postua një video për të treguar se Rita Ora e mori flamurin “vullnetarisht”, duke kundërshtuar deklaratën e këngëtares se flamurin ia “dha” një person nga publiku. Një interpretim i tillë vetëm sa i hedh benzinë zjarrit duke vazhduar shënjestrimin e serbëve si armiq historikë të shqiptarëve. Vetë Ora ka deklaruar qartë se është mendjehapur dhe nuk i paragjykon njerëzit në bazë të kombësisë, por nuk pranon kurrësi që veprimi i saj të merret si mohim i trashëgimisë së saj shqiptare apo kosovare.

Raste të tjera ku u shfaqën reagime negative ndaj serbëve kishin të bënin me ndeshje ku luanin futbollistë me origjinë shqiptare. Në një artikull mbi ndeshjen Serbi-Zvicër⁵, u theksua se trajneri serb kishte përdorur shprehje raciste ndaj shqiptarëve, ndërsa futbollisti Xhaka u kundërpërgjigj duke veshur një fanellë me emrin Jashari, mbiemri i një prej themeluesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari. Xhaka tha më pas se fanella mbante mbiemrin e një futbollisti të ri, dhe veshja e bluzës ishte një gjest inkurajimi për atë djalë që ta vazhdojë sportin. Edhe vendosja e duarve në organet gjenitale⁶ u mor si ofendim nga serbët, ndërsa Xhaka u justifikua se ajo ishte një përgjigje ndaj sharjeve dhe ofendimeve të trajnerit serb.

Në një rast tjetër, lajmi mbi martesën mes një burri serb dhe një gruaje shqiptare, u publikua me tituj që synonin të ngjallnin reagime të forta, duke cituar gruan që thotë: “Ndihem serbe”⁷. Komentet për gruan ishin shumë negative, duke e quajtur “pa shtyllë kurrizore”, “tradhtarë”, fëmijët e çiftit do të jenë “viça” – lojë fjalësh me prapashtesën e mbiemrit serb viç, - ose duke e fyer edhe seksualisht: “të pëlqen gërneta serbe” (duke aluduar organin mashkullor).

I njëjti stil vihet re në raportimin e një incidenti mes një ish-politikani shqiptar dhe policisë malazeze⁸, që u filmua ndërsa po goditej brenda makinës së tij nga dy policë me uniformë. Objekti i shkrimit të publikuar në Syri.net ishte ish-kryeministri me origjinë shqiptare Dritan Abazovic, i cili akuzohej se kishte reaguar me vonesë për këtë

3. <https://shqiptarja.com/lajm/interpretoi-ne-mes-te-skenes-ne-hungari-me-flamurin-e-serbise-te-hedhur-kraheve-rita-ora-kryqezohet-ne-rrjet-nga-fansat-video>

4. <https://joq-albania.com/artikull/1159190.html>

5. <https://shqiptarja.com/lajm/ndeshja-me-zvicren-trajneri-serb-kapet-nga-kamerat-duke-share-nenat-shqiptare-ishzv-ministria-presim-qe-fifa-te-reagoje>

6. <https://joq-albania.com/artikull/1088820.html>

7. <https://shqiptarja.com/lajm/shqiptarja-martohet-me-nje-serb-ne-leposavic-tani-ndihem-serbe>

8. <https://www.syri.net/politike/572529/dhuna-ndaj-petra-q-milos-si-i-justifikoi-policet-abazovici-i-malit-te-zi/>
https://www.instagram.com/p/Co9_nxhoUK0/

incident dhe kishte mbrojtur veprimet e policisë. Metoda e përdorur në këtë rast është fajësimi i një grupi të tërë në bazë të veprimeve të dy individëve. Abazovic u akuzua se i jep shumë mbështetje serbëve, për ta zhvlerësuar si politikan në sytë e publikut shqiptar.

Edhe gjuha e urrejtjes ndaj grekëve u riaktivizua pas një periudhe relativisht të qetë. Faktori kryesor ishte kandidimi nën siglën e opozitës i një personazhi kontrovers si Fredi Beleri, kreu i shoqatës etnike greke Omonia. Pjesëmarrja e Belerit në masakrën e Peshkëpisë, ku mbetën të vrarë dy ushtarë kufiri pas një sulmi nga territori grek, dhe veçanërisht një deklaratë për helenizimin e Himarës, ngjallën komente të shumta negative në internet. Pas kandidimit të tij, disa e perceptuan këtë lëvizje si përpjekje të qarqeve shoviniste greke për të ngritur pretendime territoriale ndaj Shqipërisë, duke ngritur sërish tezën e Vorio Epirit. Kryeministri Rama kritikoi deklaratat problematike të Belerit, dhe e akuzoi se po u bënte presion emigrantëve shqiptarë në Greqi për ta votuar. Mbrëmjen e 11 majit, Beleri u arrestua nën akuzën e blerjes së votave. Tituj artikujsh që e quajnë Belerin “gomar”⁹ - si paralelizëm me kalin e Trojës - nxitën një sërë reagimesh negative për grekët në përgjithësi, duke i bërë jehonë armiqësisë së vjetër midis dy vendeve:

Grekët, këta njerëz gjysmë femra e gjysmë dobiça, tashmë janë trimëruar dhe ju duket vetja ”palikara”, por në fakt janë ”palibytha”.

Për sa i përket komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri, ata janë vazhdimisht në shënjestër të komenteve denigruese dhe negative në media, veçanërisht kur ndodh ndonjë akt i dhunshëm nga pjesëtarë të këtyre komuniteteve. Sidoqoftë, gjatë vitit 2023 pati një rritje të ndërgjegjësimit nga shoqata të këtyre komuniteteve për të reaguar në kohë ndaj gjuhës së urrejtjes. I tillë ishte rasti i *informim.al*, që denoncoi përdorimin e fjalës denigruese “jevg” nga një regjisor i njohur gjatë një emisioni sportiv në RTSH, ku i referohej disa futbollistëve¹⁰. Në një deklaratë ku kërkonte falje, regjisori thotë se termi përcmues ishte produkt i “trashëgimie rudimentare të të shprehurit, të mbetura në nëndërgjegje nga zhargoni i komunikimit të asaj pjese të shoqërisë, që nuk është e ndërgjegjshme për efektin e fjalës në dëm të reputacionit të pakicave”.

Argumenti i “trashëgimisë rudimentare të shprehjeve mbi komunitetin rom dhe egjiptian” u konfirmua nga një tjetër incident që u denoncua si gjuhë urrejtjeje gjatë transmetimit të Big Brother në televizionin Top Channel. Edicioni i vitit 2023 pati një numër rekord shikuesish, ndaj edhe reagimi i grupit të produksionit ndaj gjuhës së urrejtjes mes konkurrentëve u bë edhe më i rëndësishëm. Njëra nga konkurrentet, ish-këngëtarja Ermiona Lekbello, u përjashtua¹¹ nga emisioni pasi përdori gjuhë përcmuese me bazë racore ndaj komunitetit egjiptian gjatë një grindjeje me një konkurrente tjetër. Nga ana tjetër, duhet theksuar se asnjë media nuk raportoi hollësisht mbi arsyen e përjashtimit, por u la të nënkuptohej se shkak ishte përdorimi i dhunës verbale. Ky mund të ishte një rast i mirë për të rritur ndërgjegjësimin mbi përdorimin rëndom të termave përcmuese ndaj komunitetit rom.

Përkundrazi, një artikull i publikuar në media¹², jo vetëm që nxiti komente negative por pati edhe thirrje për dhunë ndaj këtij komuniteti. Një media në internet publikoi mesazhin e një gruaje që ankohej se dy fëmijë romë e shtynë në rrugë para makinave duke rrezikuar që ta shtypnin. Shkrimi shoqërohej me një foto të dy fëmijëve romë që u ishin mbuluar sytë, por nuk dihet nëse ishin pikërisht ata fëmijët që shtynë gruan apo të tjetër. Edhe titulli i shkrimit që shënonte me germa të kuqe fjalët “Qytetarja e **frikësuar** nga fëmijët **romë**: Më shtynë, sa s’më hodhën para **makina**!” përforcon idenë se romët janë një komunitet i dhunshëm, që duhen pasur frikë.

Postimi pati 10,750 pëlqime në Instagram, ndërsa komentet janë të mbushura me gjuhë urrejtjeje duke filluar nga epitete përcmuese deri te thirrjet agresive për dhunë. Bien në sy edhe referencat rreth epokës komuniste dhe kryeministrit famëkeq Mehmet Shehu, që njërihej për brutalitetin e tij ndaj komunitetit rom: “Mehmet Shehu duhet ringjallur”, “Nuk kishte faj Enveri që i shtypi me buldozerë,” etj. Ky lloj raportimi është shumë i rrezikshëm, së pari për komunitetin në tërësi, dhe së dyti për fëmijët në rrugë që janë të ekspozuar ndaj reagimit të personave të acaruar. Nuk është hera e parë që mediat publikojnë mesazhe të paverifikuara, pa dhënë kontekstin e ngjarjes dhe pa e ndjekur problemin me institucionet përgjegjëse për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve. Një pakicë komentesh u munduan të ndryshonin narrativën duke bërë thirrje për një njohje më të mirë të situatës së këtij komuniteti, duke propozuar zgjidhje për disa nga problemet kryesore që shqetësojnë romët, dhe duke ofruar një këndvështrim më pozitiv.

9. <https://gazetadita.al/himara-greku-nga-progonati-dhe-disa-pyetje-qe-duan-dhe-presin-pergjigje/>
<https://javanews.al/kale-troje-apo-gomar-himare/>

10. <https://informim.al/gjuha-denigruese-ndaj-komunitetit-egjiptian-ne-rtsh-ne-qatar-2022-petri-bozo-kerkon-ndjese-publike-organizatat-protesta-do-kete-qel-lim-sensibilizues/>

11. <https://www.voxnews.al/lifestyle/e-fundit-ermiona-lekbello-perjashtohet-nga-shtepia-e-bby-i33768>

12. <https://joq-albania.com/artikull/1126724.html>
<https://www.instagram.com/p/CRk5M7kNDDO/>

Këto raste duhet të shqyrtohen me kujdes nga aspekti etik përpara botimit, në mënyrë që të shmanget ofrimi i një platforme për ata që promovojnë urrejtje. Raportimi i përgjegjshëm kërkon nga gazetarët që të kenë kujdes gjatë trajtimit të çështjeve delikate duke i shërbyer interesit më të lartë të publikut, dhe jo të nxisin gjuetinë e shtrigave ku komunitete të tëra bëhen përgjegjës për krime të vogla nga individë të caktuar si pasojë e paragjytimeve të shoqërisë, pa analizuar më parë se nga vjen ky paragjykim dhe si mund të zgjidhet.

Kundështim	Nuk ka
Reagime negative	E kanë në gjak, duan të rrinë rrugëve; Lypjen e kanë stil jete; Duhet të mbahen në muzeume si specie në rrezik zhdukje; Duhet ringjallur Mehmet Shehu
Portretizim negativ	Jevgj të poshtër; vijnë era pleh; dinë vetëm të bëjnë fëmijë dhe i lënë rrugëve; ciganë të këqinj; parazitë; insekte rrugësh; etj
Demonizim dhe çhumanizim	Kafshë, specie në rrezik zhdukje,
Dhunë	Duhet rrahur me dru; goditi me çantë, mbaj gurë me vete, ato qënie të poshtra duhet rrahur
Vdekje	Duhet lyer me benzinë (për t'i djegur); Nuk kishte faj Enveri që i shtypi me buldozerë Të zhduken

Një tjetër fenomen shqetësues që është vënë re vitet e fundit tek mediat shqiptare, është edhe përdorimi në rritje i gjuhës së urrejtjes ndaj emigrantëve me ngjyrë. Duke qenë se Shqipëria është pjesë e marrëveshjeve për pritjen e refugjatëve në territorin e saj, ndjenjat anti-emigrantë kanë filluar të rriten, dhe arritën kulmin në vitin 2023 kur u nënshkrua marrëveshja me qeverinë italiane për strehimin e përkohshëm të refugjatëve deri sa të riatdhesohen. Marrëveshja është komentuar gjerësisht në media dhe madje ka patur reagime edhe nga shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut mbi kushtet e pritjes së këtyre emigrantëve, si dhe mbi pika të diskutueshme në lidhje me sovranitetin e vendit.

Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit në këtë rast përfaqësohet më së miri nga një artikull i publikuar nga portali syri.net¹³. Hiperbola është teknika e përdorur në këtë rast për të rritur ankthin dhe frikën. Numri i madh i emigrantëve që pritet të vijnë gjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes (pesë vjet) është dhënë qëllimisht si mbërritje e të gjithë emigrantëve menjëherë, për të rritur panikun dhe për të krijuar idenë e një katastrofe.

“360,000 emigrantë, që përbëjnë 12 për qind e numrit zyrtar të popullsisë”

“Mbi 10 milionë emigrantë afrikanë që enden rrugëve duke qenë autorët kryesorë të krimeve seksuale, grabitjeve dhe kontingjentit kriminal në vend.”

Të flasësh për 10 milionë afrikanë për një vend të vogël si Shqipëria me afro 2 milionë banorë dhe me krizë emigracioni, krijon idenë e përmbytjes me emigrantë dhe zhdukjen e kombit përballë kësaj vale masive afrikanësh.

Vetë titulli “Shqipëria e Zezë e Edi Ramës, a jeni gati?” përmban nota raciste duke lënë të nënkuptohet epërsia e shqiptarëve si racë e bardhë ndaj emigrantëve që vijnë kryesisht nga Afrika. I gjithë artikulli synon të krijojë panik në popull duke i quajtur emigrantët “një bombë e madhe sociale për 5 plus 5 vitet e ardhshme” dhe duke i atribuar emigrantëve çështje të tilla si krimi apo edhe terrorizmi.

13. <https://www.syri.net/op-ed/637547/shqipëria-e-zeze-e-edi-rames-a-jeni-gati/>

“Krimet e refugjatëve, kanë qenë nga më të ndryshmet, duke nisur nga sulmet terroriste ndaj popullatës, e deri tek përdhunimet, dhuna apo grabitjet me pasoja të rënda.”

Shprehja “krimet e refugjatëve” lidh padrejtësisht krimin me refugjatët si grup shoqëror, duke i dhënë një konotacion negativ të gjithë fenomenit. Krimi është krim pavarësisht nëse kryhet nga vendas apo të huaj.

Autori i referohet një studimi nga Instituti Kombëtar i Statistikave të Italisë, duke pretenduar se “thujtë të gjitha krimet seksuale kryhen nga emigrantët”, por në artikull nuk jepet link për raportin. Si për ironi, vetë shqiptarët janë paragjykuar për përfshirjen e tyre në krimin e organizuar në Itali dhe kanë vuajtur nga raportimi negativ në media. Kjo erdhi pikërisht ngaqë shtypi italian bëri gabimin e etiketimit të një populli të tërë bazuar në veprimet e një grupi të vogël kriminelësh.

Artikulli vijon me të dhëna nga Franca, Gjermania dhe Suedia mbi krimet e emigrantëve për të arritur në përfundimin se diçka e tillë pritet të ndodhë edhe në Shqipëri me hyrjen në fuqi të marrëveshjes. E gjithë kjo krijon një klimë armiqësore, jo mikpritëse, dhe paragjykuese ndaj njerëzve që janë larguar nga komunitetet e tyre për një jetë më të mirë. Fakti që do të strehohen në një zonë plazhi, ndërkohë që Shqipëria po përjeton një rritje të ndjeshme në turizëm, rrit paragjykimet dhe tregon për një standard të dyfishtë të “mikpritjes,” që cilësohet prej shekujsh si një nga traditat më pozitive të shqiptarëve.

Tingëllon disi e çuditshme dhe artificiale që media të mbajë një qëndrim të tillë në Shqipëri, një vend me një histori të pasur dhe të trishtuar emigracioni. Ky qëndrim, edhe kur frymëzohet nga misioni i medias për të qenë kritike ndaj qeverisë mund të jetë kundërproduktiv. Përqendrimi mbi efektet negative që mund të lindin nga emigrantët e largon vëmendjen e medias nga rastet e keq-qeverisjes.

3. Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit mbi baza gjinore

Përpjekja për të komanduar jetën e vajzave, për të paracaktuar fatin e tyre dhe për të kufizuar mundësitë e grave ka qenë gjithmonë e pranishme në shoqërinë shqiptare. Një studim i fundit nga Fakteje¹⁴ arriti në përfundimin se media ka mbështetur fushatat e dezinformimit gjinor që vënë në shënjestër gratë dhe vajzat përmes përdorimit të narrativave të dëmshme: gratë duhet të rrinë në shtëpi; tradhtia bashkëshortore është arsye për të vrarë gratë; femrat e degjeneruara po shkatërrojnë familjen; të gjithë burrat që përdhunojnë janë monstra; femrave u pëlqen dhuna sepse nuk rezistojnë, edhe kur përdhunohen, etj.

Gjatë vitit 2023, u shënuar një rritje e nivelit të gjuhës së urrejtjes përmes ngjarjeve të ndryshme të pasqyruara në media, ku vihet re një tendencë e dukshme e disa individëve për të kufizuar lirinë e lëvizjes së grave dhe vajzave dhe për t’u dhënë më shumë përparësi burrave në ambiente publike.

“... ne e dimë kush shkon në stadium, një grua nuk mund të shkojë në stadium pikërisht në një ndeshje ku ajo... Tani, ka mundësi kjo grua të gjejë një biletë? Duhet t’ja marrë një burri që vjen.”¹⁵

Po kështu, me dashje apo pa dashje, gratë dhe vajzat kanë qenë shënjestër e gjuhës diskriminuese edhe në emisionet televizive të pasdites që pretendojnë se trajtojnë “temat më të nxehta të aktualitetit, histori personale dhe çështje sociale, probleme me të cilat përballemi çdo ditë dhe sugjerime për një jetë më të mirë.” Emisione të tilla, që kanë audiencë të konsiderueshme (gra dhe vajza), kanë ndezur si pa të keq debate dhe polemika mbi tema të rëndësishme dhe shumë të ndjeshme, debate mbi shëndetin dhe kapacitetin intelektual të grave, madje edhe mbi të drejtat dhe dinjitetin e tyre. Një rast i tillë ishte një deklaratë e bërë nga një gjinekolog i ftuar në Vizion Plus në lidhje me fertilitetin e femrave. Ai citohet të ketë thënë:

“... 30 vjeç quhen plaka¹⁶”

14. <https://faktoje.al/perkatesia-gjinore-dhe-dezinformimi-ne-shqiperi-si-formeson-media-qendrimet-ndaj-rovele-gjinore/>

15. Gazetari i sportit bën deklaratë talebaneske: Nuk mund të shkojnë gratë para burrave në stadium për të parë Kombëtaren! – AKTUALITET (tpz.al)

16. 30 vjeç quhen plaka, gjinekologu trondit me deklaratën: Nese nuk bejne femije deri... Vizioni i Pasdites - YouTube

duke lënë të nënkuptojë që gratë duhet të bëhen nëna para moshës 30-vjeçare. Në një rast tjetër, një avokat pretendoi gjatë një emisioni në një televizion kombëtar se gratë dhe vajzat që punojnë kthehen automatikisht në të dashurat e shefave, duke i bërë jehonë narrativës së dëmshme se gratë duhet të rrinë në shtëpi:

“Gruan ia ke falur drejtorit po e nxore në punë!”¹⁷

Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit u zhvillua me tone shumë negative gjatë vitit 2023 kur bëhej fjalë për raportimin mbi përdhunimin. Rasti i një 26-vjeçareje të përdhunuar në Vlorë nga një grup djemsh pasi u drogua dhe u la në një dhomë hoteli¹⁸ e tronditi opinionin publik dhe tërhoqi vëmendjen e medias për ditë me radhë.

Gjatë asaj periudhe u zhvilluan debate të panumërta rreth atij krimi, por deklarata e një avokati ishte një nga incidentet më flagrante të gjuhës seksiste në media. Ndërsa fliste në një televizion kombëtar për fenomenin e përdhunimit, ndër të tjera ai përmendi edhe ligjin penal anglez, duke e vënë theksin tek kohëzgjatja e rezistencës nga ana e femrës gjatë një përdhunimi, dhe më pas deklaroi se femra dorëzohet për të shijuar aktin seksual, ndonëse bëhej fjalë për përdhunim:

“Vjen një moment i caktuar që femra mbasi ka filluar të shtrëngohet për përdhunim dorëzohet nga kënaqësia.”¹⁹

Një tjetër avokate, tha në Vizion Plus se vajzat duhet të bëjnë më shumë kujdes për të shmangur abuzimin seksual, pasi “përdhunimet zakonisht ndodhin të premtëve dhe të shtunave, kur vajzat e tejkalojnë një çikë me pije. Meshkujt meshkuj janë.”²⁰ Të dyja deklaratat u kritikuan si seksiste dhe diskriminuese nga Komisioneri Kundër Diskriminimit dhe AMA, por masat e marra për këto dy raste ishin të ndryshme: stacionit të parë televiziv iu kërkua të mos e ftonte më atë person në emisione, ndërsa televizionit tjetër iu kërkua që ta hiqte videon nga kanalet në internet brenda 30 ditëve.

Është më se e kuptueshme që deklarata të tilla nga juristë tërhoqin vëmendjen e shoqërisë si opinione që vijnë nga persona me autoritet profesional, dhe nëse nuk kundërshtohen nga drejtuesit e emisionit dhe gazetarët ndikimi i tyre mund të jetë shumë negativ, duke përforcuar stereotipet e dëmshme rreth përdhunimit, sikur shkaktare për aktin ka qenë viktima dhe jo agresori. Sidoqoftë, është e rëndësishme të theksohet se reagimi i publikut në këto dy raste ka qenë në favor të grave dhe vajzave të përdhunuar, duke hedhur poshtë tezat e përmendura nga juristët.

Në atë kohë, gazetarja Afrovita H. e cila publikoi e para lajmin për përdhunimin në Vlorë, u kërcënua publikisht nga pronari i një televizioni lokal në faqen e Facebook të televizionit, duke e kërcënuar me gjakmarrie - vrasje për nder - dhe duke e quajtur “prosti” 14 herë.

“Je në gjak me mua. Prosti ishte lajmi, jo gazetarja Afrovita!”²¹

Pas ndërhyrjes së Unionit të Gazetarëve pronari i televizionit e tërhoqi deklaratën, duke pranuar se kishte vepruar në zemëratë e sipër. Justifikimi për përdorimin e fjalës “prostitutë” ishte se gazetarja kishte botuar një lajm të paverifikuar ku akuzonte djalin e tij si një nga autorët e përdhunimit.

Ky rast ngjalli debate nëse deklaratat publike kundër gazetarëve nga një person që mban një licencë transmetimi mund të gjykohen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive si incidente të gjuhës seksiste. Ndonëse AMA-s iu drejtua një ankesë nga organizata të grave për të trajtuar këtë çështje, kjo kërkesë nuk u mor parasysh pasi deklaratat ofenduese u bënë në mediat sociale, që janë jashtë juridiksionit të këtij institucioni.

Gjatë monitorimit të medias është vënë re gjithashtu se gratë vihen vazhdimisht në shënjestër nga individë apo grupe të caktuara që tentojnë të zbusin dhe manipulojnë krimet dhe “imazhin” e personave të përfshirë në to.

17. <https://www.instagram.com/reel/C02DkPONpGx/?igshid=MTc4MmMIYml2Ng%3D%3D>

18. <https://shqiptaria.com/lajm/vlore-nxiten-nje-26vjecare-te-pinte-droge-dhe-me-pas-abuzuan-seksualisht-me-t-2-te-arrestuar-l-ne-kerkim>

19. “Femrat mezi bëjnë rezistencë, shtirën sikur s’duan”- Shokun avokati Spartak Ngjela: Edhe kur përdhunohet dorëzohet nga kënaqësia (panorama.com.al)

20. https://www.instagram.com/reel/Cyv9VWos08l/?utm_source=ig_embed&ig_rid=e32bd752-546e-4ae3-96ff-6f41493a7752

21. [Lajmi për përdhunimin e 26-vjeçares në Vlorë, kërcënohet gazetarja e Faxnews Afrovita Hysaj - Faxweb](#)

Përdorimi i termave negative (prostitutë, zuskë, e pastrehë) në raportimet e krimeve me bazë gjinore, veçanërisht kur kemi të bëjmë me vrasjen apo vdekjen e një gruaje, synon të relativizojë peshën e lajmit duke e zhvendosur vëmendjen nga krimi tek profesioni i viktimës, ose përkatësia etnike. Kjo mënyrë raportimi mund të çojë në reduktimin e reagimit nga publiku.

*“Ngjarje horror në Durrës. Punonte si prostitutë, 32-vjeçarja abuzohet seksualisht dhe hidhet pa jetë mes shkurreve tek Ura e Dajlanit! Si u masakrua me thikë Luljeta Preza”.*²²

Monitorimi i medias zbuloi gjithashtu një standard të dyfishtë në raportim kur bëhet fjalë për identitetin e vrasësit. Në artikuj ku flitet për vrasjen e një burri, gazetarët nuk ngurrojnë ta përshkruajnë vrasësen si përbindësh: “Menduh Kurti, ish-i dashuri që ‘Marjeta e tmerrshme’ dogji të gjallë në Dajt”²³.

Nga ana tjetër, kur një burrë apo djalë vret tre gra brenda pak orësh në kryeqytet, mediat publikojnë artikuj, intervista dhe emisione që analizojnë profilin psikologjik të një vrasësi: “Dan Hutra ka probleme të shëndetit mendor! Kërkon dominancë mashkullore.”²⁴

Burrat dhe djemtë vihen në shënjestër të medias dhe gjuhës diskriminuese në raportime mbi incidente që kanë në qendër historinë e një gruaje. Gratë dhe vajzat vihen në lojë në mënyrë indirekte nga gazetarët, me humor apo me sarkazëm, nëpërmjet një vëllai, burri, babai ose personi të afërt. Ky lloj diskursi, përveç urrejtjes dhe diskriminimit, ndikon edhe në përforcimin e retorikës seksiste, përçmuese, si dhe në nxitjen e urrejtjes dhe përçarjes në shoqëri.

Niveli	Diskurs urrejtje / diskriminimi mbi baza gjinore
Kundërshtim	Burri e vrau Liridonën ngaqë i kërkonte divorc.
Reagime negative	Kush e fton këtë idiot on televizion??? Zhduke fare se është turp. Çfarë plehre pa pikë lezeti.
Portretizim negativ	“Prosti” (gazetarja që botoi lajmin mbi përdhunimin në Vlorë) A e di kush ta q... motrën? Bastard! Ti je shembull tipik i degjenerimit. Këtyre femrave as femër nuk i thua dot; këto rrisin monstra dhe i marrin me të mira Mbase i ka treguar e ëma për takimet e veta me sigurimin e shtetit (i referohet avokatit që ka qenë në burg gjatë regjimit komunist si i burgosur politik) Ato ecin përpara vetëm duke hapur këmbët Femrat nuk duhet të pinë në shoqërinë e meshkujve që nuk i njohin mirë, mos i besoni!
Demonizim & çhumanizim	I tmerrshëm/ Kriminel/ Përdhunues/ Idiot! Shëmtirë. Pijanec. Njeri i shpifur. Të urrej. I pashpirt. I dështuar. Injorant.
Dhunë	Kanë luajtur mendsh, kanë nevojë për psikolog.
Vdekje	Nga POLITIKA në PERVERSITET. I çmendur komplet, ah mor ENVER! Këto monstra kishe të drejtë që i bëre sapun.../ të shkretët ne, çfarë bëhet... këto plehra duhen varur në qendër të qytetit... përndryshe nuk vënë mend të tjerët / Vare në litar atë “qen”! Pa gjyq fare /

22. <http://www.panorama.com.al/ngjarje-horror-ne-durres-punonte-si-prstitute-32-vjecarja-abuzohet-sksualisht-dhe-hidhet-e-pajete-mes-shkurreve-tek-ura-e-dajlanit-si-u-masakrua-me-thike-luljeta-preza/>

23. <https://joq-albania.com/artikull/1093421.html>

24. <https://www.balkanweb.com/dan-hutra-ka-probleme-te-shendetit-mendor-psikologia-per-autorin-e-vrasjes-qe-tronditi-kryeqytetin-kerkon-dominance-mash-kullore-profil-i-tij-psikologjik/#gsc.tab=0>

Është interesante të analizohet evoluimi i diskursit online, dhe një nga zhvillimet pozitive është reduktimi i gjuhës së urrejtjes kundër grave në platformat e mediave sociale në krahasim me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shtimi i komenteve agresive në lidhje me deklaratat apo incidente që përfshijnë burrat dhe djemtë, si dhe komente negative nga gratë dhe vajzat kundër njëra-tjetrës mbeten probleme shqetësuese.

Kemi vënë re se sistemi që mban gjallë gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit ndaj grave po zgjerohet për shkak të ndërveprimit midis mediave tradicionale dhe mediave të reja; për shkak të lehtësisë së botimit / reagimit / raportimit pa treguar ndonjë ndjeshmëri gjinore apo njerëzore nga ana e gazetarëve, profesionistëve, artistëve, influencuesve nga bota e artit, sportit, politikës apo biznesit.

Në bazë të analizës emocionale, niveli mesatar i gjuhës së urrejtjes dhe gjuhës diskriminuese ndaj grave arrin në shkallën 3.9. Narrativat që demonizojnë gratë janë çnjerëzore, shumë agresive, dhe diskriminuese deri në maksimum.

Për sa i përket burimeve të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit ndaj grave, gazetarët dhe mediat janë shkakuar kryesorë të këtij problemi, të ndjekur më pas nga personazhe të njohur të jetës publike, akademike, intelektuale, qytetarë të thjeshtë të publikut online, politikanë dhe profesionistë të tjerë. Modernizimi i medias ka “ndihmuar” në përhapjen e një diskursi denigrues ndaj grave dhe vajzave pasi ka krijuar një hapësirë të pakontrollueshme në portale apo platforma të mediave sociale për persona që nuk ngurrojnë të shprehin opinione negative, zakonisht kundër grave.

Po kështu, për shkak të metodave dhe taktikave krejt të pandershme dhe joprofesionale për shtimin e shikueshmërisë dhe klikimeve nëpërmjet botimit të titujve sensacionalë dhe publikimit të fotografive të paautorizuara, gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit po përhapet me ritme alarmante. Kjo reflektohet nga incidente dhe shkrime që tërheqin vëmendjen e 18,000, ose edhe më shumë se 80,000 personave përmes platformave të mediave sociale.

4. Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit ndaj LGBTQ+

Narrativa mbi komunitetin LGBTQ+ në Shqipëri vazhdon të dominohet nga gjuha e urrejtjes dhe diskriminimit, por në vitin 2023 kjo u shkaktua nga një intensifikim i lëvizjes pro-familje, e udhëhequr nga individë që dalin hapur kundër të drejtave të LGBTQ+. Krahas ngjarjeve brenda vendit, në media u publikuan edhe artikuj nga bota mbi krime dhe persona LGBTQ+, duke krijuar një terren pjellor për gjuhën e urrejtjes, sidomos po të kemi parasysh opinionet e publikut mbi këto çështje.

Si shembull mund të merren dy raste që i referohen ngjarjeve të ndodhura në SHBA, ku një çift homoseksual u shpall fajtor për abuzim seksual të fëmijëve të tyre, dhe një person transgjinnor kreu një vrasje masive në një shkollë.

Tema, gazeta me tirazh më të madh në Shqipëri, raportoi mbi incidentin e parë duke botuar një artikull me titull: “Tragjika e dy të miturve të birësuar nga një çift gay.” Në artikull jepet një përshkrim i krimeve të kryera nga çifti duke përfshirë abuzimin seksual, shitjen e fëmijëve të tyre për seks, pornografi, etj. Artikulli pa emër autori i quan subjektet e shkrimit “çift i pështirë homo” duke e përdorur këtë rast për të bërë një përgjithësim për të gjithë komunitetin LGBTQ+: “ky rast tregon më së miri se pas homoseksualitetit, një **çmenduri njerëzore** shndërruar dhe në një axhendë **imponuese**, ajo që e pason si **çmenduri** është adoptimi i fëmijëve prej tyre, duke jua garantuar këtë edhe ligjërisht, pas lejitimit të martesave, po aq të **çmendura**, të të njëjtit seks.” Vini re përsëritjen tre herë të fjalës “çmenduri” për të nënvizuar opinionin se homoseksualiteti është sëmundje mendore. Lidhja e pedofilisë me komunitetin LGBTQ+ është jashtëzakonisht e dëmshme, pasi sugjeron pa të drejtë një lidhje midis homoseksualitetit dhe pedofilisë. Komentet mbi artikullin në faqen e gayetës Tema janë po aq problematike, pasi përdoruesit shprehën (përmes homofobisë ekstreme) shqetësimin për birësimin e fëmijëve nga çiftet LGBTQ+.

Në artikullin kushtuar ngjarjes së vrasjes në një shkollë të SHBA nga një person transgjinior u botua një artikull me titull “Vrau 6 persona mes tyre 3 fëmijë, momenti kur transgjiniorja hyn me automatik në shkollën e krishterë.” Kjo e lidh krimin me identitetin seksual, duke sugjeruar se individët LGBTQ+ janë të prirur ndaj kriminalitetit. (Disa nga artikujt nuk e identifikuan autoren si femër transgjiniore, jo mashkull, duke përdorur terminologji të gabuar). Disa media theksuan gjithashtu se sulmi u krye në një shkollë të krishterë, duke i mëshuar narrativës “LGBTQ+ kundër kishës”. Shumica dërrmuese e komenteve ishin të mbushura me urrejtje, duke i uruar vdekje komunitetit LGBTQ+, dhe u përqendruan veçanërisht tek rreziku që individët dhe komuniteti LGBTQ+ “paraqesin për fëmijët, madje edhe duke i vrasur.” Postimi në JOQ me artikull dhe foton e vrasëses mori 10,146 pëlqime. Ndonëse disa nga komentet në portal u përpoqën të bënin dallimin midis veprimeve individuale dhe identitetit seksual, shumica i quanin “të çmendur”, “të sëmurë mendorë”, duke iu uruar vdekjen ose nxjerrjen jashtë ligjit.

“Këta (njerëz) sjellin sëmundje, shkatërrojnë vlerat, moralin, kulturën dhe traditën e një kombi”

Kundërshtim	Nuk ka
Reagim negativ	O zot i madh. Duhet ndaluar me ligj. Duhet forcuar ligjet kundër tyre. Nuk njohin kufij, nuk i njohin ligjet e natyrës që e ka krijuar Zoti, ata që i ndihmojnë, i vdekshin fëmijët Duhet të izolohen se nuk janë normalë.
Portretizim negativ	Imoralë, I ka ik truni përlesh, transgjiniotë është sëmundje mendore, skizofreni, kancer i kulturës së ndyrë të Hollivudit, Nuk është seksualitet por është sëmundje mendore Këta (njerëz) sjellin sëmundje, shkatërrojnë vlerat, moralin, kulturën dhe traditën e një kombi Perverse Komuniteti LGBTQ+ është një komunitet me sëmundje mendore dhe çrregullime personaliteti Psikopatë
Demonizim dhe çhumanizim	Monstër Ata janë kundër Zotit, kjo pritjet prej tyre. Zombi Shtrigë
Dhunë	
Vdekje	Ja pse personat LGBTQ+ nuk meritojnë të jetojnë; duhet vrasur (meritojnë) Të digjen të gjallë Bam, mu në lule të ballit Këto qenie nuk e meritojnë të jetojnë I vraftë Zoti Ju vraftë Zoti edhe në jetën e përtejme Një shtet në Afrikë ka miratuar një ligj që i dënon me vdekje ata që hyjnë në organizatë LGNT (gabim shkrimi për LGBT), dhe mirë kanë bërë, Të zduken këto transa, të vdesin të gjithë Duhet varur të gjallë Këto lloj qëniesh duhet eliminuar sa më shpejt Duhet në digjen me vaj të nxehtë

Narrativa mbi personat LGBTQ+ që synojnë të lëndojnë fëmijët dominoi edhe emisionin e mëngjesit të Syri TV “Kafe Shqeto”. Vetë titulli “Kush po i shtyn fëmijët drejt komunitetit LGBTQ+?”, e tregon qartë pozicionin e redaksisë mbi këtë temë. Debati midis Linda Panos, përfaqësuese e lëvizjes Pro-Familje, dhe Luana Myrtos, një transgjimore, degjeneroi shumë shpejt, ndërsa Pano lëshoi akuza se propaganda LGBTQ+ po i shtyn fëmijët drejt degjenerimit seksual. Ajo keqpërdori informacione nga një sondazh i Gallup që sipas saj tregonte se “20 për qind e fëmijëve e konsiderojnë veten pjesë të komunitetit LGBTQ+ dhe 80 për qind e fëmijëve janë të pavendosur.” Paraqitja e këtyre të dhënave në kreun e kronikës tregon paragjykimin e medias ndaj këtij komuniteti, duke përdorur shprehjet “shumë e shpejtë” dhe “shumë shqetësuese.”

“Numri i fëmijëve që u kërkohet të bëhen pjesë e komunitetit LGBTQ+ po rritet shumë shpejt dhe në mënyrë shumë shqetësuese. Këto janë rezultatet e studimit të fundit nga Gallup.”

Për më tepër, drejtuesi i emisionit iu drejtua vazhdimisht Luana Myrtos me emrin e saj të mëparshëm, Luan, duke e cënuar plotësisht personalitetin dhe individualitetin e saj.

Narrativa rreth personave LGBTQ+ fokusohet mbi konfliktin mes “ne heteroseksualëve” dhe “atyre homoseksualëve,” ku grupi “ne” përfaqëson të mirën, moralin e dhënë nga Zoti, ndërsa “ata” mishërojnë djallin, degjenerimin, të keqen në shoqëri. Në këtë kontekst, çdo ngjarje dhe veprime të ndërmarra kundër këtij komuniteti shihet si betejë dhe shoqërohet nga fjalët “fitore”, ose “humbje”. Si shembull mund të merret lajmi mbi një vendim të Gjykatës Administrative për rrëzimin e vendimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi vitin e kaluar, që vendosi se pastori Akil Pano, kreu i Aleancës për Mbrojtjen e Familjes, kishte përdorur gjuhë urretje agresive kundër komunitetit LGBTQ+ në Shqipëri. Pano dhe media²⁵ e konsideruan këtë vendim si një “fitore” ligjore kundër “prindit 1 dhe prindit 2” dhe komunitetit LGBTQ+. Kjo nuk qëndron pasi iniciativa “prindi 1 dhe prindi 2” u tërhoq nga legjislacioni në vitin 2022, ndaj nuk mund të flitet për fitore të “nënës dhe babait” ndaj “prindit 1 dhe prindit 2”.

25. <https://newsbomb.al/fitore-e-madhe-e-familjes-pastori-akil-pano-fiton-gjyqin-kunder-agiendes-se-komunitetit-lgbt-per-prindin-1-dhe-prindin-2/>



Analiza krahasimore

Duke analizuar artikujt mediatikë që përmbajnë diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit gjatë vitit 2023, vëmë re disa metoda dhe tipare të ngjashme të përhapjes së gjuhës së urrejtjes dhe diskursit diskriminues për të vënë në shënjestër komunitete të ndryshme në Shqipëri, por sidoqoftë ka edhe disa dallime.

Së pari, **diskursi diskriminues i urrejtjes drejtohet kundër grupeve më të prekshme të shoqërisë si gratë, pakicat etnike, refugjatët ose personat LGBTQ+.** Këto janë grupe që nuk kanë mbështetje të fortë politike, kështu që sulmi ndaj tyre bëhet më i lehtë. Përdorimi i stereotipeve të dëmshme që i përfaqësojnë këto grupe ato si pjesa më “e keqe” e shoqërisë apo si “mënyra normale e ekzistencës” kontribuojnë në përforcimin e normave shoqërore që nuk i lejojnë këto grupe të marrin pjesë në jetën publike.

Së dyti, **raportimi mbi grupet e marginalizuara të shoqërisë shpesh kufizohet në ngjarje të izoluar që kryhen nga individë që i përkasin këtyre grupeve duke përdorur tituj sensacionalë.** Seleksionimi vetëm i ngjarjeve negative ku përfshihen individë nga këto komunitete, zakonisht në krime brenda apo jashtë vendit, pa përdorur kontekstin dhe duke hiperbolizuar pa bazë rrezikun që kanoset, gjeneron më shumë urrejtje dhe nxit komente diskriminuese nga publiku. Këto komente diskriminuese përhapen në mënyrë virale në rrjetet sociale dhe bëhet më e vështirë që të luftohen efektet negative të mbulimit mediatik.

Së treti, **diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit po intensifikohet gjithnjë e më shumë nga përhapja e narrativave të dëmshme nga profesionistë si avokatë, mjekë.** Këto deklarata të dëmshme nuk kundërshtohen nga gazetarët dhe drejtuesit e emisioneve, që madje i përdorin këto citate dhe informacione të rreme për të shkruar tituj sensacionalistë në mediat sociale për të tërhequr sa më shumë klikime dhe reagime. Për fat të mirë, publiku ka shfaqur një nivel më të lartë emancipimi në disa raste, duke hedhur poshtë këtë lloj diskursi dhe duke iu kundërvënë autorëve të tyre. Sidoqoftë, në shumë pak raste është vënë re edhe një gjykim negativ i viktimave nga publiku.

Së katërti, **diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit vazhdon të përhapet duke përdorur forma të kombinuara të elementeve verbale (me shkrim dhe fjalë) dhe vizive (video, fotografi, meme).** Rritja e shikueshmërisë të emisioneve si Big Brother ose emisionet e takimeve romantike ka krijuar një terren të ri ku mund të lulëzojë diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit. Kjo e përkeqëson akoma më tepër situatën po të kemi parasysh popullaritetin e këtyre formateve në mediat sociale. Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit shpesh shoqërohet me humor, nëpërmjet publikimit të memeve dhe shakave në mediat sociale, sidomos në emisione humoristike në televizion, veçanërisht kur bëhet fjalë për femrat, minoritetet dhe refugjatët.

Nga ana tjetër, vihen re edhe disa dallime ndërmjet rasteve dhe kategorive të diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në varësi të burimit. Për çdo kategori të gjuhës së urrejtjes ka zakonisht më shumë se një burim, duke përfshirë gazetarë dhe personelin mediatik, figura politike, figura publike, influencues dhe persona privatë (publiku në internet). Është e rëndësishme të nënvizohet fakti se gazetarët dhe moderatorët nuk janë gjithmonë përgjegjës të drejtpërdrejt të gjenerimit të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Problemi është se shpesh nuk i kundërvihen gjuhës së urrejtjes, ndërkohë që ofrojnë vizibilitet dhe platforma për përhapjen e mesazheve diskriminuese. Duke “cituar thjesht atë që u tha” dhe duke e vendosur direkt në titull, pavarësisht nga mesazhi i urrejtjes që mund të përmbajë, gazetarët po kontribuojnë në përhapjen e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit.

Nivele të ndryshme të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit shpërndahen në platforma dhe media të ndryshme; por sidoqoftë, ajo që transmetohet në televizion publikohet edhe në gazeta, portale informative online dhe në mediat sociale.

Angazhimi i vendit kundër gjuhës së urrejtjes

Masat e ndërmarra kundër gjuhës së urrejtjes në nivel kombëtar nuk kanë qenë të mjaftueshme apo të vazhdueshme. Sidoqoftë, ka patur disa nisma pozitive nga institucione publike, organizata të medias, ente regullatore të medias, dhe organizata të shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2023 u shënuar një zhvillim pozitiv dhe pati një rritje të rolit të organeve rregullatore në parandalimin e seksizmit në mediat audiovizive. Si AMA ashtu edhe Komisioneri Kundër Diskriminimit ishin më aktivë në krahasim me një vit më parë.

Në rastin e AMA-s kjo erdhi kryesisht për shkak të ndryshimit të ligjit mbi mediat audiovizive më 13 Prill 2023, ku u fut për herë të parë përkufizimi mbi seksizmin dhe u vendosën sanksione për operatorët që shkelin ligjin. Amendamenti mbi seksizmin ishte rezultat i një procesi njëvjeçar të iniciuar nga shoqata Gruaja Shqiptare në Audiovizual (AWA – *Albanian Woman in Audiovisual*) në kuadër të harmonizimit të legjislacionit me BE-në. Miratimi i një kodi të ri transmetimi nga AMA ku përfshihet një kapitull i ri mbi barazinë gjinore dhe seksizmin ndihmoi në harmonizimin e përpjekjeve me Kuvendin për ta bërë kodin e detyrueshëm për operatorët audiovizualë që mbulojnë pjesën më të madhe të tregut të medias në vend. Bashkimi i forcave mes OSHC-ve në luftën kundër seksizmit në media solli një shtim të numrit të ankesave të bëra pranë AMA në vitin 2023 mbi gjuhën seksiste. Në disa raste reagimi i Këshillit të Etikës tek AMA nuk ka qenë i kënaqshëm, duke mohuar se ka patur komente seksiste tek emisionet e humorit, por në raste të tjera televizionet janë urdhëruar që të heqin përmbajtjen seksiste nga kanalet mediatike.

Gjatë kësaj periudhe është vënë re se jo vetëm që duhet të shtohen përpjekjet për edukimin e publikut mbi median dhe mizogjininë, por edhe vetë anëtarët e Këshillit të Etikës, që duhet të analizojnë ankesat për përmbajtje seksiste, kanë nevojë për ndihmën e ekspertëve ligjorë. Po kështu, duhet të intensifikohet fushata informuese rreth ndryshimeve në legjislacion, paralelisht me trajnimin e operatorëve mediatikë se si të parandalojnë dhe t'i kundërvihen opinioneve dhe pikëpamjeve që bien ndesh me ligjin dhe kodin e transmetimit. Nga ana tjetër duhet të forcohet bashkëpunimi midis AMA-s dhe OSHC-ve duke përdorur të gjitha burimet në dispozicion, dhe duke krijuar sinergji për të luftuar diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit ka konsoliduar punën dhe praktikën ndër vite dhe konsiderohet gjithnjë e më shumë si një institucion serioz në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Interpretimet dhe arsyetimet që shoqërojnë vendimet e këtij institucioni janë të plota dhe shumë profesionale, çka është veçanërisht e rëndësishme në një situatë kur gjuha seksiste është një element i ri në legjislacionin shqiptar. Komisioneri ka marrë 240 vendime gjatë vitit 2023²⁶, duke përfshirë nëntë raste të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit në bazë të përkatësisë etnike, gjinisë dhe orientimit seksual në media. Komisioneri mori vendime në favor të dy prej këtyre ankesave dhe konstatoi diskriminim, ndërsa shtatë ankesa të tjera nuk u konsideruan si raste diskriminimi. Pjesa më e madhe e ankesave mbi diskursin e urrejtjes dhe diskriminimit vijnë nga organizatat LGBTQ+, të ndjekura nga individë apo organizata rome dhe egjiptiane.

Së fundmi, është e rëndësishme të theksojmë se është rritur ndërgjegjësimi dhe reagimi nga organizatat e shoqërisë civile në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes në media. Në dy raste, organizatat e të drejtave të romëve dhe egjiptianëve i kanë bërë thirrje dy prej televizioneve më të mëdha – RTSH dhe Top Channel – që të kërkojnë falje publike. Një nga këto televizione (RTSH) u detyrua të kërkonte falje publike pas një proteste të organizuar para godinës të televizionit. Televizioni tjetër reagoi vetëm duke përjashtuar një nga konkurrentet e Big Brother pasi përdori një term përcmues për komunitetet rome dhe egjiptiane. Po kështu, edhe AWA (Gruaja Shqiptare në Audiovizual) ka qenë shumë aktive në denoncimin e gjuhës seksiste në mediat audiovizive pas ndryshimit të ligjit. Nga tre ankesa që bëri kjo shoqatë gjatë vitit 2023, dy prej tyre ishin të suksesshme, ndërsa për ankesën e tretë AMA ka pranuar të marrë këshilla ligjore mbi këtë çështje.

²⁶ <https://www.kmd.al/vendime-te-komisionerit-2023/>

Konkluzione

Ky raport u përqendrua mbi monitorimin e incidenteve që përmbanin gjuhën e urrejtjes dhe diskriminimit në lidhje me gjininë, përkatësinë etnike, fenë, pakicat seksuale, emigrantët dhe refugjatët, etj. Raste të tilla janë regjistruar në mediat tradicionale, mediat e reja dhe në mediat sociale.

Tre kategoritë që janë bërë më shpesh shënjestër e gjuhës së urrejtjes dhe diskursit diskriminues ishin gjinia (41 për qind), përkatësia etnike (38 për qind) dhe pakicat seksuale (11 për qind).

Intensiteti i diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në median shqiptare u vlerësua nga analiza emocionale me nivelin 3, çka përbën një nivel mesatar, me një retorikë që karakterizohet nga narrativa fyese, ofendime dhe gjuhë jo të dhunshme. Sidoqoftë, kjo nuk e redukon ndikimin negativ që kanë këto narrativa përçarëse mbi grupet e vëna në shënjestër dhe shoqërinë në tërësi.

Gratë dhe vajzat vazhdojnë të jenë objektivi kryesor i diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në vendin tonë, me një përshkallëzim shqetësues gjatë raportimit e dhunës ndaj grave, veçanërisht në rastet e përdhunimeve. Mediat janë bërë platforma për shpalosjen e teorive për fajësimin e viktimave nga figura publike si avokatë, pa i kundërshtuar këto pseudoteori dhe madje duke i përdorur këto deklarata reaksionare për të tërhequr më shumë klikime në faqet e mediave sociale. Në këto raste, publiku ka reaguar në mbrojtje të grave dhe vajzave që gjykohen për veprimet e tyre, dhe kanë kritikuar ashpër ata persona që justifikojnë deri diku përdhunimet dhe abuzimet seksuale. Në këtë kontekst, vihet re një rritje e nivelit të emancipimit të publikut në lidhje me përhapjen e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit në të tilla raste, nga ose nëpërmjet mediave. Diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit kundër përkatësisë etnike po intensifikohet në Shqipëri, duke arritur kulmin ndaj emigrantëve që vijnë në Shqipëri si pjesë e marrëveshjeve ndërshtetërore, duke përdorur argumente dhe fjalor të ekstremit të djathtë, çka nuk është e natyrshme për Shqipërinë, si një vend me një histori të pasur dhe të trishtuar emigracioni. Po kështu, edhe diskursi i urrejtjes dhe diskriminimit kundër komunitetit LGBTQ+ është gjithnjë i pranishëm, veçanërisht në mediat online.

Aprovimi i amendamentit të ligjit mbi mediat audiovizive në prill të vitit 2023, duke futur një nen specifik të veçantë mbi seksizmin, dhe miratimi i kodit të ri të transmetimit për mediat audiovizive, pritet të kontribuojnë në reduktimin e diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit, së paku në raport me gratë dhe vajzat. Sidoqoftë, puna për ndërgjegjësimin e publikut dhe medias rreth diskursit të urrejtjes dhe diskriminimit duhet të vazhdojë në bashkëpunim të ngushtë me institucionet dhe shoqërinë civile.



Referenca

Universiteti George Washington (2019). Monitoring Hate Speech in the US Media. Working paper. Media and Peacebuilding Project, (*Monitorimi i gjuhës së urrejtjes në mediat amerikane. Punë kërkimore. Projekti i Medias dhe Sigurimit të Paqes*) faqe 5. Mund të lexohet në internet tek kjo faqe: [Monitoring-Hate-Speech-in-the-US-Media-3_22-z0h5kk.pdf](https://www.cpb-us-e1.wpmucdn.com/3_22-z0h5kk.pdf) (cpb-us-e1.wpmucdn.com)

Përkatesia gjinore dhe dezinformimi në Shqipëri. Si formëson media qëndrimet ndaj roleve gjinore? <https://faktoje.al/perkatesia-gjinore-dhe-dezinformimi-ne-shqiperi-si-formeson-media-qendrimet-ndaj-roleve-gjinore/>

Vendime të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, 2023: <https://www.kmd.al/vendime-te-komisionerit-2023/>

Papa Françesku dënon djegien e Kuranit: <https://www.evropaelire.org/a/papa-francesku-denon-djegien-e-kuranit/32487299.html>

Këndoi në skenë në Hungari me flamurin e Serbisë të hedhur kraheve, Rita Ora 'kryqëzohet' në rrjet! Këngëtarja: Nuk e pashë cilit shtet i përkiste: <https://shqiptarja.com/lajm/interpretoi-ne-mes-te-skenes-ne-hungari-me-flamurin-e-serbise-te-hedhur-kraheve-rita-ora-kryqezohet-ne-rrjet-nga-fansat-video>

Pamje të reja! Rita Ora e mori vetë flamurin serb nga fansat: <https://joq-albania.com/artikull/1159190.html>

Tensionet në ndeshjen Zvicër-Serbi, trajneri serb filmohet duke sharë nënat shqiptare! Xhaka reagon për fanellën 'Jashari': Nuk ishte politike: <https://shqiptarja.com/lajm/ndeshja-me-zvicren-trajneri-serb-kapet-nga-kamerat-duke-share-nenat-shqiptare-ishzv-ministrja-presim-qe-fifa-te-reagoje>

Çmenden serbët/ Xhaka u tregon pjesët intime, ata tentojnë ta sulmojnë: <https://joq-albania.com/artikull/1088820.html>

Shqiptarja martohet me një serb në Leposaviç: Tani ndihem serbe: <https://shqiptarja.com/lajm/shqiptarja-martohet-me-nje-serb-ne-leposavic-tani-ndihem-serbe>

Dhuna ndaj Petraç Milos/ Si i justifikoi policët, Abazoviçi i Malit të Zi: <https://www.syri.net/politike/572529/dhuna-ndaj-petraç-milos-si-i-justifikoi-policet-abazovici-i-malit-te-zi/>

Himara, 'greku' nga Progonati dhe disa pyetje që duan dhe presin përgjigje: <https://gazetadita.al/himara-greku-nga-progonati-dhe-disa-pyetje-qe-duan-dhe-presin-pergjigje/>

Kalë Troje apo gomar Himare!: <https://javanews.al/kale-troje-apo-gomar-himare/>

Gjuha denigruese ndaj komunitetit egjiptian në RTSH në QATAR 2022, Petri Bozo kërkon ndjesë publike, organizatat: 'Protesta do ketë qëllim sensibilizues': <https://informim.al/gjuha-denigruese-ndaj-komunitetit-egjiptian-ne-rtsh-ne-qatar-2022-petri-bozo-kerkon-ndjese-publike-organizatat-protesta-do-kete-qellim-sensibilizues/>

Ermiona Lekbello përjashtohet nga shtëpia e BBV: <https://www.voxnews.al/lifestyle/e-fundit-ermiona-lekbello-perjashtohet-nga-shtepia-e-bbv-i33768>

Qytetarja e frikësuar nga fëmijët romë: Më shtynë, sa s'më hodhën para makinave: <https://joq-albania.com/artikull/1126724.html>

Shqipëria 'e zezë' e Edi Ramës! A jeni gati?: <https://www.syri.net/op-ed/637547/shqiperia-e-zeze-e-edi-rames-a-jeni-gati/>

Fitore e madhe e familjes, pastori Akil Pano fiton gjyqin kundër agjendës së komunitetit LGBT për Prindin 1 dhe Prindin 2: <https://newsbomb.al/fitore-e-madhe-e-familjes-pastori-akil-pano-fiton-gjyqin-kunder-agjendes-se-komunitetit-lgbt-per-prindin-1-dhe-prindin-2/>

Gazetari i sportit bën deklaratë talebaneske: Nuk mund të shkojnë gratë para burrave në stadium për të parë Kombëtaren! <https://www.tpz.al/aktualitet/gazetari-i-sportit-ben-deklarate-talebaneske-nuk-mund-te-shkojne-grat-i227503>

30 vjeç quhen plaka, gjinekologu trondit me deklaratën: <https://www.youtube.com/watch?v=pISkvtNbwP4>

Shokon Zaçe Islami: Gruan po e nxore për punë, ia ke falur drejtorit! <https://www.instagram.com/reel/C02DkPONpGx/?igshid=MTC4MmMIYml2Ng%3D%3D>

Droguan dhe më pas përdhunan 26-vjeçaren! Arrestohen dy të rinj në Vlorë, shpallet në kërkim i treti: <https://shqiptarja.com/lajm/vlore-nxiten-nje-26vjecare-te-pinte-droge-dhe-me-pas-abuzuan-seksualisht-me-t-2-te-arrestuar-1-ne-kerkim>

“Femrat mezi bëjnë rezistencë, shtiren sikur s’duan”- Shokon avokati Spartak Ngjela: Edhe kur përdhuhet dorëzohet nga kënaqësia <http://www.panorama.com.al/femrat-mezi-bejne-rezistence-shokon-avokati-spartak-ngjela-edhe-kur-prdhuhet-dorezohet-nga-kenaqesia>

https://www.instagram.com/reel/Cyv9VWos08l/?utm_source=ig_embed&ig_rid=e32bd752-546e-4ae3-96ff-6f41493a7752

Lajmi për përdhunimin e 26-vjeçares në Vlorë, kërcënohet gazetarja: <https://pamfleti.net/aktualitet/lajmi-per-in-e-26-vjecares-ne-vlore-kercenohet-gazetarja-i194832>

Ngjarje horror në Durrës/ Punonte si pr*stitutë, 32-vjeçarja abuzohet s*ksualisht dhe hidhet e pajetë mes shkurreve tek Ura e Dajlanit! Si u masakrua me thikë Luljeta Preza <http://www.panorama.com.al/ngjarje-horror-ne-durres-punonte-si-prstitute-32-vjecarja-abuzohet-sksualisht-dhe-hidhet-e-pajete-mes-shkurreve-tek-ura-e-dajlanit-si-u-masakrua-me-thike-luljeta-preza/>

Menduh Kurti, ish-i dashuri që “Marjeta e tmerrshme” dogji të gjallë në Dajt <https://joq-albania.com/artikull/1093421.html>

“Dan Hutra ka probleme të shëndetit mendor”, psikologjia për autorin e vrasjes që tronditi kryeqytetin: Kërkon dominancë mashkullore. Profili i tij psikologjik... <https://www.balkanweb.com/dan-hutra-ka-probleme-te-shendetit-mendor-psikologjia-per-autorin-e-vrasjes-qe-tronditi-kryeqytetin-kerkon-dominance-mashkullore-profili-i-tij-psikologjik/#gsc.tab=0>



RAPORT MONITORIMI PËR GJUHËN
E URREJTJES NË SHQIPËRI



Funded by
the European Union



The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

